KRONIKË E ZEZË

Arrestohen 12 persona për "trafikim me njerëz" e "prostitucion"

22 shkurt 2023, 11:06

Shpërndaje në

Në gjashtë operacione policore të ndara këtë javë, janë arrestuar 12 persona të dyshuar për "trafikim me njerëz", "mundësim apo detyrim në prostitucion" dhe vepra të tjera që ndërlidhen me trafikimin, ka bërë të ditur Policia e Kosovës në një komunikatë për media të mërkurën. Sipas njoftimit, është identifikuar një viktimë e trafikimit dhe dy viktima të keqtrajtimit apo braktisjes së fëmijës.

Personat e arrestuar janë: A.Th., (viti i lindjes 1978, mashkull kosovar); A. Xh., (viti i lindjes 1997, femër kosovare); E. M., (viti i lindjes 1993, mashkull kosovar); F. H., (viti i lindjes 2000, femër kosovare); D. I., (viti i lindjes 1991, femër kosovare); J. H., (viti i lindjes 1994, femër kosovare); Sh. I., (viti i lindjes 1981, femër kosovare); Gj. G., (viti i lindjes 1993, femër kosovare); M. Th., (viti i lindjes 2000, femër kosovare); A. B., (viti i lindjes 1997, mashkull kosovar); J. J., (viti i lindjes 1991, femër kosovare) dhe Q. H., (viti i lindjes 1963, mashkull kosovar).

Gjatë këtyre operacioneve janë kontrolluar edhe tri objekte, dy prej tyre sallone masazhi dhe një shtëpi private, si prova materiale janë sekuestruar: 1 armë zjarri/revole, 3 fishekë 9 mm, 5 telefona mobilë, dokumente tjera të nevojshme që kontribuojnë në hetimin e rastit.

Policia ka thënë se operacioni policor është zhvilluar pas shkëmbimit të informatave me autoritetet e Austrisë, "ku edhe është bërë identifikimi i një viktime të moshës së mitur, e cila po trajtohet sipas Procedurave Standarde të Veprimit për personat e trafikuar".

Nga 12 të arrestuarit 6 prej tyre u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

#PROSTITUCION

Shqiptari arrestohet në hyrje të Kroacisë, u kap me 11 kg heroinë
Edukatorja në Mitrovicë godet me shuplakë fëmijën
Grabitje në një market në Mitrovicë
Shtyhen dy seanca për rastin e vrasjes së Ivanoviqit
Arrestohet një i dyshuar në Prizren për sulm seksual
Dhunë në familje gjithandej Kosovës në 24 orët e fundit
Prizren, dy persona marrin lëndime ndërsa po punonin në renovimin e një shtëpie

Taboola Feed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megazbritje.al | Sponsored

Albania Residents Might Get Online MBA Courses in USA
Best Online MBA Courses in USA | Search Ad | Sponsored

Ushtarit rus i bie bomba afër trupit, shikoni reagimin e tij
Një ushtarit rus i ra shumë pranë trupit një bombë që iu hodh nga lart, shkroi blogu ukrainas Operativno_SDU. Në pamjet e publikuara të martën, shihet një ushtar që po qëndronte i …
Kohanet

The Prices Of A Masters Degree in Germany Might Actually Surprise You
Study in Germany | Search Ad | Sponsored

The Prices Of A Project Management Masters Degree Might Actually…
Business Degrees | Search Ads | Sponsored

People from Albania Might Not Believe Used Car Prices
Used Cars | Search | Sponsored


Putinit zihet në rrenë në fjalimin e gjatë
Të martën, gjatë një fjalimi para deputetëve dhe popullit rus, në prag të njëvjetorit të nisjes së luftës në Ukrainë, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, folu për "përpjekjet e regjimit në Kiev …
Kohanet

Looking to become a US citizen? You may be able to make an investment on US soil
US Citizen Invest | Search ads | Sponsored

TË TJERA

Arrestohet një person në Fushë-Kosovë, i dërgoi foto me armë gruas që kishte urdhër-mbrojtës

Vidhet vula në zyrën e Gjendjes Civile në një fshat të Prizrenit

Shuma që përvetësoi i dyshuari në Gjilan që mashtroi duke kërkuar ndihma për "persona të sëmurë"

Një grua në Çaglavicë raporton se i është përdhunuar vajza, arrestohet i dyshuari

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe internet a rrjetet tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.